

## COVID 19. REFLEKTIME

**Franc Zylyftari**

**Msc. Viti II, Marrëdhënie Ndërkombëtare, UMSH**

### **Libri ‘vaksina’ e një virusi**

A mund të jetë një libër një vaksinë virusi?! A mund shërojë një libër?!



Do të ishte marrëzi të identifikonim librin si vaksinën shpëtimtare të Covid por ai mund të jetë ilaci preventues i qytetarëve të paprekur. Ritmi i jetes i shumë prej nesh mund të jetë i lartë në një ditë normale kryesisht nga angazhimet e shumta dhe ajo që ne na duhej ishte një ‘pushim absolut’. ‘Pushimi absolut’ i cilësuar si një luks për dikë që zotëron disiplinën e punës vjen duke u venituar kur pas disa javësh monotonia zëvendëson qetësinë. Disiplina e punës nuk është atribut i shumicës shqiptare dhe ampermatësi më i mirë do të ishin lokalet gjatë ditëve të javës. Mos-postimi i shumtë në rrjete sociale të aksesoreve, makinave të huazuara, ushqimeve të larmishme dhe verës është një rrufe në qiell të hapur. Frekuentimi i shpeshtë i restoranteve, kafeneve dhe klubeve të nates është zëvendësuar me tribunën qëndrore (kolltukun përpara TV). Fallsiteti si mekanizëm karakterizues i Instagramit nuk ka më ‘ushqim’. Varfëria e postimeve sjell gjëndjen dëshpëruese dhe te ankthit.

Te paragjykosim ose gjykosim është cënimin i të drejtave të njeriut sepse jeta është personale. Një këshillë nuk është kurrë e tepërt, këshilla jonë është ti drejtohem i librit. Asnje prej nesh nuk është fajtor për nivelin e analfabetizimit i cili është 57% (raport Banka Botërore 2013). Te jemi të sigurtë, nëse shkëmbimi i mesazheve në adoleshencë si një nevojë biologjike ndërmjet gjinive nuk do të kryhej, përqindja e analfabetizimit do të ishte shumë e lartë! Ne nuk jemi fajtor për të shkuarën por jemi përgjegjës të së ardhmes. Buzëqeshim kur të moshuarit shprehen që sytë e tyre janë të brezi i ri, ata na shohin ne si shpëtimtarë të Shqipërisë së gjymtuar. Shqipëria e gjymtuar, e keqpërdorur dhe e paralizuar, e cila nuk la analfabet pa e kthyer në deputet. Ushtari nuk mund të shkojë në armë pa luftë, nuk mund të hyjë në Europë me 57% nivel analfabetizmi. Mjekët luftojnë virusin e vërtetë atë vdekjeprurës, le të luftojmë në krahe të virusin që ka infektuar edukimin.

***“Edukimi është arma më e fuqishme që mund të përdoret për të ndryshuar botën”***

***Nelson Mandela***